



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

.IV. Nr. i prot. 1055 Më 06.7.2023
Br. prot. Dt. RAHOVEC - ORAHOVAC

Raport nga DKA për përfundimin e vitit mësimor 2022-2023

Të nderuar këshilltarë të Kuvendit Komunal!

Drejtoria Komunale e Arsimit para se të fillonte procesi mësimor sipas kalendarit të hartuar nga MASHTI, i bëri të gjitha përgatitjet e nevojshme. Megjithatë edhe ky vit shkollor 2022-2023 nuk filloi me kohë, por me një vonesë një muajshe, për shkak të grevës së mësimdhënësve, e cila u mbështet dhe u përkrah nga SBASHK-u, anëtarë të së cilës janë shumica e mësimdhënësve të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar. Për shkak të grevës, procesi mësimor filloi më 3 tetor 2022.

Synimet kryesore e DKA-së për vitin shkollor 2022-2023, ishin:

- Funksionalizimi i plotë i Aktiveve Profesionale dhe Këshillave Drejtuese në secilën shkollë;
- Riparimet në shkolla dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore;
- Investime për përfundimin e plotë për ndërtimin e 3 çerdheve për fëmijë;
- Vazhdimi i projekteve për përfundimin e ndërtimit të shkollave të filluara nga vitet e mëparshme;
- Fillimi i ndërtimit të shkollave të reja;
- Furnizimi i shkollave me libra, pajisja me mjete konkretizimi e laboratorike dhe teknologji informative.
- Veprime të duhura për të përmirësuar performancën e sistemit edukativo arsimor në komunën tonë.

AKTIVITETET KRYESORE TË DREJTORISË PËR ARSIM GJATË VITIT SHKOLLOR 2022-2023

Në muajin shtator, në objektet e shkollave “Isa Boletini”, “Bekim Sylka” dhe “12 Maji”, kanë vazhduar punimet në ndërmarrjen e masave të efijencës së energjisë, por, këto punime për shkak të zhagjitjeve nga kompanitë punëkryese, nuk janë kryer në kohën e paraparë, në mënyrë që objektet të jenë të gatshme më 1 shtator. Në shkollën fillore “Rilindja” në Çifllak përfunduan punimet në projektin e ndërtimit të parkingut dhe rrethojës së oborrit të shkollës.

Më 13 shtator morëm pjesë në një sesion informues të organizuar nga GIZ - gjerman dhe Organizata RYCO lidhur me një projekt për të rinjtë e shkollave të mesme të larta, në të cilin këto shkolla do të aplikojnë. Si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut, u përmyt nga uji shkolla në Sapniq, por objekti i shkollës dhe oborri i saj u pastruan nga kompania “Vetoni” dhe nga njësitë i zjarrfikësve i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Viti i ri shkollor filloi më 3 tetor, pas pezullimit të grevës nga SBASHK-u dhe BSPK-ja, e cila kishte filluar që nga data 25 gusht 2022. Pas lidhjes së kontratës për lëndë ngohëse, ka filluar furnizimi i objekteve shkollore me dru dhe pelet. Me Aktivat Profesionale të të gjitha fushave kurrikulare kemi mbajtur takimin e radhës, në të cilin përfaqësuesit e këtyre aktiveve morën përsipër të kryejnë punë në zgjerimin e Pakos Pedagogjike edhe për klasat e larta (9-12). Kemi pranuar një donacion me libra (përmbledhje poezish) nga familja e shkrimtarit të ndjerë Hysni Gashi. Ky donacion dedikuar shkollave të komunës sonë u nda përmes Shoqatës “Arbëria”. Është lidhur kontrata për ndërtimin e objektit të ri të Shfmu “Hamëz Thaçi” në Xërxë. Ka përfunduar furnizimi i të gjitha objekteve shkollore me dru dhe pelet . U mbajt trajnimi dy ditor i Eko klubeve të 3 Shkollave të Mesme të Larta, në kuadër të fillimit të zbatimit të projektit “Të rinjtë për Mjedisin”. Kemi përgatitur raportin 3 mujor të DKA-së dhe kemi prezantuar në seancën e Kuvendit Komunal Informatën e DKA-së për fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023. Procesi mësimor u mbajt rregullisht, por zëvendësim të ditëve të humbura ditëve të shtunave nuk pati.

Me vënien e gurthemelit, filloi puna në ndërtimin e objektit të ri të SHFMU “ Hamëz Thaçi” në Xërxë. Kanë filluar punimet në riparimin dhe inventarizimin e Qendrës së Karrierës në Shkollën Profesionale në kuadër të projektit “YENI”. Është lidhur kontrata për projektin “Ndërtimi i aneksit të objektit të SHFMU “Katër Dëshmorët” në Ratkoc. Gjatë muajit nëntor janë zhvilluar vizita sistematike shëndetësore tek nxënësit e klasave të para dhe të pesta të shkollave fillore. Nga Policia e Kosovës kanë vazhduar të mbahen ligjërata vetëdijësuese për sigurinë në përdorimin e internetit nga nxënësit e klasave të 7, 8 dhe 9. Kanë përfunduar instalimet elektrike të kalldajës në SHFMU “Skënder Kastrati” në Malësi të Vogël dhe ky problem u zgjidh. Ka përfunduar projekti i rregullimit të fushës sportive në oborrin e shkollës “12 Maji” në Ratkoc. Ka filluar furnizimi me inventar për objektin e ri të shkollës në Retijë. Më 19 nëntor u mbajt Gara Komunale e Olimpiadës Matematike ndërmjet nxënësve të klasave 9, 10, 11 dhe 12. Pas përfundimit të projektit për rregullimit të fushës sportive në oborrin e shkollës “12 Maji” në Ratkoc, u bë përrurimi i saj. Ka vazhduar furnizimi me inventar për objektin e ri të shkollës në Retijë dhe në prag të festës së 28 Nëntorit, u bë përrurimi i kësaj shkolle. Furnizimi me inventar u bë edhe për Shfmu “Faik Konica”

në Celinë. Në të gjitha shkollat e komunës sonë u mbajtën manifestime kulturore dhe artistike për nder të Festës së 28 Nëntorit.

Më 3 dhjetor, dërguam në Garën Republikane të Olimpiadës Matematike 8 nxënësit fitues të Garës së Olimpiadës Komunale. Nga kjo garë, nxënësja jonë nga klasa e 11-të e Shkolllës së Mesme të Lartë “Xhelal Hajda-Toni” fitoi vendin e tretë. Punimet kanë vazhduar edhe në projektin e ndërtimit të objektit të ri të Shfmu “Hamëz Thaçi” në Xërxë, ndërsa në Shfmu “Katër Dëshmorët” përruam fillimin e punimeve. Është lidhur kontrata për projektin e rregullimit të ngrohjes qendrore në objektin e SHFMU “Rudolf Walther” në Dejnë dhe punëkryesi menjëherë ka filluar dhe ka realizuar këtë projekt. Me Caritasin Zviceran mbajtëm trajnimin dy ditor me mësimdhënësit e 3 shkollave të mesme të larta, pjesëtarë të Eko Klubeve. Ndërkohë, gjatë muajit dhjetor rregulluam edhe këndin e lodrave për fëmijë në oborrin e Çerdhes për Fëmijë “TULIPANËT” në qytet dhe përruam objektin e ri të Çerdhes për Fëmijë në Xërxë. Poashtu, në këtë muaj përruam edhe Qendrën e Dytë Arsimore për Komunitete në Shkollën “Gëzim Hamza-Piktori”, e cila u pajis me mjete konkretizimi, laboratorike dhe teknologji informative.

Të hyrat sipas muajve në Çerdhen e Fëmijëve “TULIPANËT” deri në fund të vitit 2022, i kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Të hyrat e çerdhes së fëmijëve
“TULIPANËT” në Rahovec
për vitin 2022

Muaji	Të hyrat
Janar	3,195.00 €
Shkurt	3,420.00 €
Mars	3,540.00 €
Prill	3,690.00 €
Maj	3,690.00 €
Qershor	3,495.00 €
Korrik	1,035.00 €
Gusht	0.00 €
Shtator	0.00 €
Tetor	3,165.00 €
Nëntor	3,390.00 €
Dhjetor	2,805.00 €
Gjithsej	28,230.00 €

Në javën e parë të muajit janar 2023, kanë vazhduar punimet e filluara në projektin e riparimeve të brendshme në shkollën “Bekim Sylka” dhe paralelisht me këto, kanë vazhduar punimet edhe në efizienzë. Punimet poashtu kanë vazhduar edhe në projektin e ndërtimit të objektit të ri të Shfmu “Hamëz Thaçi” në Xërxë.

Kemi vazhduar me përgatitjet e duhura të paramasave për 2 projekte; projektin e furnizimit të shkollave me pako pedagogjike dhe projektin e furnizimit të bibliotekave të shkollave me libra. Pas pushimit me rastin e festës së Vitit të Ri, më 4 janar rifilloi mësimi në të gjitha shkollat dhe procesi mësimor u zhvillua normalisht. Mbajtëm një takim me Aktivat Profesionale të DKA-së në të cilin diskutuam për finalizimin e Pakos Pedagogjike. Mbajtëm një takim në Shkollën Profesionale dhe po ashtu një takim tjetër përgatitor me Këshillin Organizues për Manifestimet e Flakës së Janarit. Përgatitëm Planin Tremujor të punës së DKA-së për vitin 2023. Kemi filluar me procedurën e prokurimit për projektin e furnizimit të bibliotekave të shkollave me libra. Mbajtëm një takim me zyrtarët e divizionit për infrastrukturë në MASHT për fillimin e zbatimit të 2 projekteve nga niveli qendror, ai i çerdhes për fëmijë në qytet dhe projekti për ndërtimin e objektit të shkollës në Pastasel. Mësimi në të gjitha shkollat përfundoi për gjysmëvjetorin e parë dhe gjysmëvjetori i dytë filloi më 6 shkurt 2023. Nga AME kemi marrë pëlqimin për mbrojtjen nga zjarri për objektin e ri të çerdhes në Krushë të Madhe.

Edhe gjatë muajit shkurt, kanë vazhduar punimet në përfundimin e projektit të riparimeve të brendshme në shkollën “Bekim Sylka”, ku është bërë shtruarja e dysHEMEVE me epoksid dhe ka vazhduar lysterja e fasadës së mureve të brendshme. Po ashtu, kanë vazhduar punët edhe në projektin e ndërtimit të objektit të ri të aneksit në Shfmu “Katër Dëshmorët” dhe në projektin e riparimeve të nyjeve sanitare të shkollës në fshatin Sapniq. Kemi nisur procedurën e prokurimit për projektin Furnizimi i shkollave me Pakon Pedagogjike.

Mësimi në të gjitha shkollat për gjysmëvjetorin e dytë filloi më 6 shkurt 2023, pas pushimit një javor. Kemi punuar në përgatitjen e paramasave për fillimin e projektit për furnizimin e shkollave me mjete dhe pajisje laboratorike. Mbajtëm takim me drejtorët e shkollave, koordinatorët e cilësisë dhe kryetarët e Këshillave Drejtuese të Shkollave (KDSH). Më 11 shkurt mbajtëm Garën Komunale të Fizikanëve të Rinj, me nxënësit e klasave 9, 10, 11 dhe 12. Gjatë këtij muaji kanë përfunduar punimet në projektin e riparimeve të nyjeve sanitare të shkollës në fshatin Sapniq. Mbajtëm edhe disa aktivitete garuese e kulturore me rastin e festës së 17 shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës.

Mbajtëm një takim me përfaqësues të QPS-së, Drejtorisë së Shëndetësisë, OJQ-të dhe me Shoqatën Down Syndrome Kosova për koordinimin e aktiviteteve ndërmjet tyre për përkujdesjen ndaj fëmijëve me nevoja të veçanta. I dërguam për të marrë pjesë në Garën Shtetërore të Fizikanëve të Rinj, nxënësit fitues të Garës Komunale. Gjatë këtij muaji kemi punuar në përgatitjen e paramasave të projektit të riparimeve në shkolla.

U mbajtën ligjërata vetëdijësuese për sigurinë në komunikacion në bashkëpunim me policinë. Kemi bërë përgatitje për festën e 7 marsit – Ditës së Mësuesit. Me rastin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit dhe Shkollës së Parë Shqipe, mbajtëm një program festiv me mësimdhënësit dhe nxënësit e të gjitha shkollave. Kanë vazhduar të zhvillohen punime në projektin e ndërtimit të

objektit të ri të aneksit në Shfmu "Katër Dëshmorët", ku janë ndërtuar muret e katit të parë. Punimet kanë filluar edhe në projektin e zbatimit të masave të efijencës së energjisë në objektin e Shfmu "Dëshmorët e Zatriqit" në Zatriq.

Kemi punuar në përgatitjen e paramasave të projektit të riparimeve në shkolla dhe kemi nisur procedurën për këtë projekt, ndërkohë që së bashku me drejtorinë e administratës nisëm procedurën për projektin "Mirëmbajtja dhe rregullimi i hapësirave të jashtme dhe të brendshme të objekteve publike". Së bashku me menaxherin e projektit dhe inxhinierët, kemi vizituar punishtet ku po vazhdojnë punimet në projektin e ndërtimit të objektit të ri të aneksit në Shfmu "Katër Dëshmorët", dhe në projektin e ndërtimit të objektit të Shfmu "Hamëz Thaçi". Patëm një takim me Kolegjiumin për Arsim në kuadër të AKK-së dhe realizuam një vizitë në shkollën e fshatit Sapniq. Dorëzuam një kërkesë në MASHTI për pajisjen e IAAP-së me tri kabinete, në kuadër të thirrjes që kishte bërë MASHTI.

Në fillim të muajit prill, përgatitëm Planin e Punës të DKA-së për tremujorin e dytë. Kemi mbajtur një takim në MASHT ku ishim pjesëmarrës të gjithë drejtorët e drejtorive komunale nga të gjitha komunat. Mbajtëm një takim edhe me drejtorët e shkollave dhe me kryetarët e këshillave drejtuese të shkollave. Punimet për instalimin e ndriçimit të brendshëm që u zhvilluan në objektin e Shfmu "Bekim Sylka" përfunduan në javën e parë të muajit prill.

Hapëm konkursin për bursa për studentë dhe për nxënës. U përruan projektet e efijencës dhe të renovimeve të brendshme në objektin e Shfmu "Bekim Sylka". U shënuar Dita e Shkollës "Dëshmorët e Lirisë" në Pataqan të Poshtëm. Nga projektet e zbatimit të masave të efijencës së energjisë, përveç që është punuar në objektin e Shfmu "Dëshmorët e Zatriqit" në Zatriq, punët kanë filluar edhe në objektin e Shfmu "Rilindja" në Çifllak. Përgatitëm dhe dërguam në MASHT projektin ideor të Çerdhes për Fëmijë që pritet të ndërtohet në qytet. U shënuar Dita e Tokës me aktivitete pastrimi me të gjithë nxënësit dhe mësime dhënësit e të gjitha shkollave. Projektin ideor të Çerdhes për Fëmijë që pritet të ndërtohet në qytet ia dhamë detyrë kompanisë projektuese për ta shndërruar në projekt final. Në Shkollën "Hamëz Thaçi" në Xërxë, bëmë homazhe dhe nderime pranë bustit të dëshmorit në 24 vjetorin e rënies. U bë furnizimi me libra për bibliotekat e shkollave nga operatori me të cilin kemi kontratë. U shënuar manifestime për Ditën e Shkollës, në Shkollën "Faik Konica" në Celinë dhe në Shkollën "Nesimi Elshani" në Nagac.

Gjatë muajit maj, u bë furnizimi i plotë me libra për bibliotekat e shkollave nga operatori me të cilin kemi kontratë dhe filluam shpërndarjen e tyre nëpër bibliotekat e shkollave. Pas marrjes së pranimi teknik nga KEDSI në Prizren, bëmë kërkesë për ta pajisur stacionin e pompave të ujit dhe objektin e çerdhes për fëmijë në Krushë të Madhe me njehsor elektrik. Kyçja e rrymës në këtë çerdhe u bë gjatë këtij muaji. U shënuar Dita e Shkollës në IAAP "Selajdin Mullaabazi-Mici" e poashtu u përrua themelimi i Qendrës për Zhvillimin e Karrierës në këtë Institucion të Arsimit dhe Aftësimi Profesional. U zhvilluan vizita në monumente kulturore e historike nga nxënësit e Shkollave të Mesme të Larta, në koordinim me Drejtorinë e Kulturës dhe Qendrën Rinore. Realizuam 5 vizita kontrolli nga zyrtarët e DKA-së në 5 shkolla. U shënuar manifestime për Ditën e Shkollave dhe aktivitete përkujtimore për nder të Javës së Dëshmorëve në Shkollën "Milaime

Në qershor, vazhduam me furnizimin me libra nëpër bibliotekat e disa shkollave dhe furnizimin e shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike. U bënë përgatitjet e fundit dhe përruam 2 çerdhet për fëmijë në Krushë të Madhe dhe në Ratkoc, më 1 qershor 2023. Po në këtë ditë, organizuam dhe mbajtëm aktivitete të ndryshme për fëmijë, siç ishte Shfaqja Teatrale me Kukulla në Qendrën e Kulturës “Mensur Zyberaj”. Organizuam dhe mbajtëm garën komunale të diturisë ndërmjet nxënësve nga klasa e tretë deri në klasat e 12-a, në shumicën e lëndëve mësimore. Në këtë garë morën pjesë të gjitha shkollat. Stacioni i pompave të ujit për Çerdhen në Krushë të Madhe u pajis me orëmatësin e rrymës elektrike.

Nga rezultatet e publikuara nga MASHTI, më 3 korrik 2023, dolën këto rezultate:

Morën pjesë 408 maturantë	100%
Kaluan 238 maturantë	58.3%
Nuk kaluan 170 maturantë	41.6 %

Pas shpalljes së rezultateve të Testit të Arritshmërisë, gjatë muajit korrik do të hapet konkursi për pranimin e nxënësve në klasat e dhjeta të 3 SHML-ve dhe të IAAP-së.

Drejtor i DKA në Rahovec

